



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Nr. 43 | Prot.
39

Tiranë, më 30 .05. 2025

Drejtuar : **MINISTRISË SË FINANCAVE**
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BUXHETIT
DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BUXHETIT

TIRANË

Lënda: Raporti i Monitorimit të Buxhetit për periudhën Janar-Prill të vitit 2025.

Në mbështetje të Ligjit nr. 115/2024 “Për buxhetin e vitit 2025”, në vijim të udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 9, datë 20.03.2018, “Procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar, Udhëzimit nr. 14, datë 30.05.2023 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në NJQQ”, lutemi gjeni bashkëlidhur Raportin e Monitorimit të Buxhetit të 4-mujorit të parë të vitit 2025 të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Raporti i monitorimit të katër mujorit Janar–Prill 2025 krahas analizës së shpenzimeve buxhetore në nivel programi përmban dhe një analizë të objektivave institucionale referuar performancës buxhetore të orientuar drejt rezultateve.

Duke Ju falënderuar për bashkëpunimin,

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

Valbona Gaxha



HYRJE

KLSH ka kryer monitorimin e buxhetit të periudhës Janar-Prill 2025, nëpërmjet vlerësimit të performancës së fondeve buxhetore dhe krahasimit të treguesve faktikë të performancës me ato të planifikuar. Nëpërmjet këtij raporti monitorimi evidentohet niveli i realizimit të fondeve buxhetore të KLSH-së të detajuar në nivel kategori shpenzimi buxhetor kundrejt treguesve të planifikuar duke mundësuar në këtë mënyrë riorientimin dhe sigurimin e një informacioni shtesë për të përmirësuar procesin e planifikimit dhe të menaxhimit të buxhetit. Në vijimësi dhe strukturat respektive të KLSH-së kanë kryer monitorimin e treguesve buxhetore më qëllim ndjekjen në vijimësi të objektivave të synuar dhe të përcaktuar në Deklaratën e politikës së programit të KLSH-së të përfshirë në Strategjinë e Zhvillimit Institucional 2023-2027.

Në mbështetje të Ligjit nr.115/2024“Për buxhetin e vitit 2025”, dhe në vijim të udhëzimit të Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë nr. 9, datë 20.07.2018, “Procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar, Udhëzimit nr. 22, datë 17.11.2016 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në NJQQ”, për periudhën Janar-Prill 2024, performanca e realizimit të buxhetit, paraqitet si më poshtë:

PROGRAMI 01120 “VEPRIMTARI AUDITUESE E KLSH-së”

Buxheti i akorduar për programin “Veprimtari audituese e KLSH-së”, ka në bazë të tij Deklaratën e Politikës të hartuar gjatë procesit të PBA 2025-2027 dhe është në funksion të kësaj Deklarate. Politika buxhetore e KLSH-së është fokusuar në përmbushjen me cilësi të lartë dhe në kohë të detyrimeve ligjore, të objektivave, si dhe prioriteteve të institucionit të parashikuar në Planin e Zhvillimit Strategjik 2023-2027, duke konsideruar kërkesat e organizmave ndërkombëtarë të auditimit dhe të BE-së të përcaktuara në MSA-në e Shqipëri-BE dhe të monitoruara në kuadrin e Integritimit Evropian.

“RAPORTI I SHPENZIMEVE FAKTIKE TË PROGRAMIT SIPAS ARTIKUJVE PËR PERIUDHËN JANAR-PRILL 2025”

Në zbatim të Ligjit nr. 115/2024, “Për buxhetin e vitit 2025”, është bërë miratimi i çeljes dhe rishikimit të fondeve buxhetore për vitin 2025, për institucionin e Kontrollit të Lartë të Shtetit. Fondet e alokuara për funksionimin e aktivitetit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, sipas zërave për vitin 2025, paraqiten si më poshtë:

Në mijë lekë

Kap.	Artikulli	Kod Projekti	Fakti 2024	Kod Projekti	Plani Vjetor	Plani Progresiv	Shpenzime Thesari	%
01	600	Paga	456,121	92401AA	531,300	176,000	153,520	87.2%
01	601	Sigurime	69,813	92401AA	66,800	24,000	23,683	98.7%
	600+601		525,934		598,100	200,000	177,204	88.6%
01	602	Mallra dhe shërbime	71,082	92401AA	80,700	34,950	17,222	49.3%
01	605	Transferta me jashtë	292	92401AA	200	200	100	50.2%
01	606	Ndihma	1,151	92401AA	1,500	1,500	0	0.0%
	602,605,606		72,525		82,400	36,650	17,323	47.3%
.01	231	Pajisje informatike	0	M240009	7,000			
.01	231	Mjete transporti	4,920	M240002	3,000			
.01	231	Rikonstruksion ndërtesa	0	M240003	4,000			
.01	231	Pajisje Zyre	1,522	M240010	1,000			
.02	230	Kosto Lokale	2,190					
.02	230	TVSH	1,817					
	230-231		10,450		15,000	0	0	

231	Grand I Huaj	2,908		273			
230	Financimi I Huaj	4,129				4,758	
	Totali	615,946	0	695,500	236,923	199,284	84.1%

ANALIZA E REALIZIMIT TË BUXHETIT TË KLSH-SË PËR PERIUDHËN JANAR-PRILL 2025

Bazuar ne Ligjit 115/2024, "Për buxhetin e vitit 2025" KLSH për vitin 2025 u miratua fondi në total në vlerën 695,500 mijë lekë, nga të cilat 680,500 mijë lekë për shpenzime korente dhe 15,000 mijë lekë Shpenzime Kapitale me Financim te Brendshëm

1. Shpenzime Personeli. Llogaria 600-601.

Fondi i alokuar nga buxheti i shtetit për vitin 2025 në zbatim të Ligjit nr.115/2024 "Për buxhetin e vitit 2025", për zërin "Paga dhe Sigurime " është në vlerën për 598,100 mijë lekë dhe numri i miratuar i punonjësve është 243 punonjës.

Për periudhën progresive Janar-Prill buxheti i planifikuar në masën për 200,000 mijë lekë është realizuar në vlerën për 177,203 mijë lekë ose realizuar në masën 89%.

Shuma e shpenzuar në zërin Shpenzime Personeli, përfshin pagat e punonjësve të KLSH-së dhe të ekspertëve të jashtëm të përkohshëm të kontaktuar dhe paguar konform shkresave dhe kontratave të nënshkruara me ta.

2. Shpenzime për Mallra dhe Shërbime të Tjera. Llogaria 602.

Fondi i alokuar nga buxheti i shtetit për vitin 2025 në zbatim të Ligjit nr.115/2024 "Për buxhetin e vitit 2025", për zërin shpenzime operative, është në vlerën për 80,500 mijë lekë, ose 11,6 % e planit buxhetor të vitit 2025.

Plani për periudhën Janar-Prill në vlerën për 34,950 mijë lekë është realizuar në vlerën për 17,222 mijë lekë ose është realizuar në masën 47%.

Me këtë zë shpenzimesh janë përballuar mbulimi i nevojave administrative të shpenzimeve si shpenzime për shërbimin e sigurisë, drita, ujë, telefon, kancelari, bateri për ups etj. Një pjesë të konsiderueshme në shpenzimet operative e zënë shpenzimet për udhëtim e dieta brenda dhe jashtë vendit në vlerën 12,888 mijë lekë dhe që përfaqësojnë 13% të shpenzimeve të planifikuara të këtij zëri.

Aktualisht, për vitin 2028, KLSH , ka realizuar disa procedura prokurimi në lidhje me:

-Blerie licenca IT. Prokurimi i blieres së licensave IT të sipërpërmendura i ka shërbyer KLSH-së për funksionimin optimal të pajisjeve të teknologjisë së informacionit, rritjen e sigurisë së rrjetit si dhe lehtësimin e punës së përdoruesve të infrastrukturës teknologjike të KLSH-së.

-Shërbim interneti për institucionin, mirëmbajtje ashensori, sistem alarmi, mirëmbajtje kondicionerësh, etj.

3. Transferta korrente dhe të huaja. Llogaria 605.

Për periudhën raportuese 2025, janë shlyer detyrimet për kuota anëtarësimi për organizatat INTOSAI dhe EUROSAI, si dhe kuotat e pjesëmarrjes në aktivitetet ndërkombëtare në shumën 100 mijë lekë nga 200 mijë lekë të planifikuara.

4. Transferta për buxhetet familjare. Llogaria 606.

Gjatë periudhës ushtrimore 2025, është dhënë Fond i Veçantë nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë në vlerën 1,500 mijë lekë, për daljen e punonjësve në pension, rast fatkeqësie dhe sëmundjeje vlerë e cila përgjatë kësaj periudhe nuk është shpenzuar.

5. Shpenzime për investime kapitale. Llogaria 230-231.

Bazuar në Ligjin nr. 115/2025, "Për buxhetin e vitit 2025", plani i buxhetit me destinacion Investimet Kapitale është në shumën 15,000 mijë lekë investime me Financim të Brendshëm.

<i>Në mijë lekë</i>		
Kodi I Projektit	Pershkrimi	Plani Vjetor
M240009	Paisje kompjuterike	7,000,000
M240002	Automjete	3,000,000
M240003	Rikonstruksion godine	4,000,000
M240010	Paisje Zyre	1,000,000
	Totali	15,000,000

Për vitin 2025, KLSH ka nisur procedurat e prokurimit për fondet në vlerën 3,000 mijë lekë për blerje automjeti, dhe 4,000 mijë lekë për rikonstruksionin e godinës.

ANALIZA E OBJEKTIVAVE INSTITUCIONALE, REFERUAR BUXHETIT TË ORIENTUAR NË REZULTATE PER PERIUDHEN JANAR-PRILL 2025.

KLSH përgjatë vitit 2025 vijoi veprimtarinë menaxheriale institucionale suportuar nga një qeverisje e brendshme efektive dhe mirëfunksionimi të sistemeve të kontrollit të brendshëm duke siguruar përputhshmërinë me standardet e kontrollit të brendshëm me qëllim sigurimin e një zhvillimi të qëndrueshëm dhe përmbushjen e objektivave Strategjike në nivelin e pritshmërive të synuara drejt konsolidimit të reformave të ndërmarra, në përputhje me standardet ndërkombëtare të auditimit, ISSAI, me rekomandimet e Progres Raporteve të BE, me detyrimet kushtetuese dhe me pritshmërinë e Kuvendit, publikut dhe të gjitha palëve të interesit.

I. MISIONI, VIZIONI DHE OBJEKTIVAT E KLSH-së

Kontrolli i Lartë i Shtetit është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar. Ai i nënshtrohet vetëm Kushtetutës dhe ligjeve.

Misioni

Kontrolli i Lartë i Shtetit është institucion i pavarur, kushtetues, i cili nëpërmjet ekspertizës dhe auditimeve cilësore, mbështet Kuvendin dhe informon publikun dhe palët e interesit në mënyrë të vazhdueshme, të paanshme dhe të plotë mbi përgjegjshmërinë që qeveria dhe entet publike tregojnë në menaxhimin e parasë së taksapaguesve, me qëllim përmirësimin e shërbimeve publike.

Vizioni

KLSH është një institucion model që udhëheq nëpërmjet shembullit, që nxit rritjen e përgjegjshmërisë, transparencës, dhe përmirësimin e shërbimeve publike, nëpërmjet auditimeve cilësore dhe luftës kundër korrupsionit, duke forcuar integritetin dhe besimin e publikut tek institucioni.

Objektivat:

Tre qëllimet strategjike që do të udhëheqin punën e KLSH-së në pesë vitet e ardhshme janë:

1. Rritja dhe përmirësimi i rolit të KLSH si mbështetës i Kuvendit për llogaridhënie efektive dhe shqyrtim të kujdesshëm e të thelluar të enteve përdoruese të fondeve publike.
2. Rritja e impaktit të punës audituese në qeverisjen e mirë, nëpërmjet përmirësimit të nivelit të zbatimit të rekomandimeve.
3. Optimizimi i kapaciteteve profesionale me qëllim zotërimin e njohurive inovative në punën audituese.

MBI REALIZIMIN E OBJEKTIVAVE TË MENAXHIMIT INSTITUCIONAL.

A-Treguesit kryesore të veprimitarisë audituese.

Kontrolli i Lartë i Shtetit, për periudhën Janar-Prill 2025, ka vijuar punën audituese në zbatim të planit të miratuar me vendimin nr. 218, datë 15.11.2024, të Kryetarit të KLSH, duke kryer dhe evaduar 16 misione auditimi, në vlerësim të përputhshmërisë dhe rregullshmërisë financiare, performancës, IT dhe ndjekjes së statusit të zbatimit të rekomandimeve të lëna në periudha të mëparshme. Detajuar sipas llojit të auditimit, aktiviteti auditues paraqitet në tabelën në vijim:

Lloji i auditimit	Nr. Auditimesh	Pesha në %
IT	2	12.5%
Përputhshmërie	2	12.5%
Përputhshmërie për çështje të veçanta (Tematik)	1	6.3%
Zbatim rekomandimesh	10	62.5%
I kombinuar	1	6.3%
Total auditime	16	100%

1. Institucionet ku janë kryer auditimet

Në periudhën Janar - Prill 2025, auditimet e kryera kanë përfshirë vlerësimin e aktivitetit në 55 subjekte, duke përfshirë nivele të ndryshme të qeverisjes si: institucione qendrore, ministri dhe agjenci (përfshirë drejtori qendrore dhe rajonale në varësi të tyre), njësi të vetëqeverisjes vendore, drejtori të përgjithshme të administrimit fiskal, si dhe shoqëri aksionere me kapital shtetëror në të cilat shteti zotëron mbi 50% të aksioneve, apo projekte me financim të huaj.

Opinionet/mesazhet/konkluzionet sipas llojit të auditimit

Bazuar në planin vjetor 2025, Kontrolli i Lartë i Shtetit, për periudhën Janar - Prill 2025, ka përfunduar kryerjen e 16 misioneve të auditimit, duke konkluduar në:

- 4 opinione për auditime përputhshmërie;
- 2 konkluzione në auditime IT
- 10 konkluzione mbi zbatimin e rekomandimeve
- 1 konkluzione në auditim financiar

Opinionet/mesazhet/konkluzionet

- 3 opinione të modifikuar (Financiare & Përputhshmërie)
- 2 konkluzione në auditime IT
- 10 konkluzione mbi zbatimin e rekomandimeve
- 1 konkluzione në auditim financiar
- 1 konkluzione për çështje të veçanta

Rekomandimet sipas natyrës.

	Masa e rekomanduara	Në numër
1	Masa Organizative	73
2	Masa Shpërblim Dëmi	3
3	Efekte negative për shkak të parregullsive	6
4	Mangësi në aktivitetin kontrollues tatimor	5
5	Masa Disiplinore dhe Administrative	5
	Total	73

2.1 Përmirësimet Ligjore dhe Masat Organizative.

Gjatë periudhës Janar-Prill 2025, për 16 auditimet e përfunduara, KLSH ka adresuar rekomandime për 73 masa organizative në institucionet publike të audituara, me qëllim marrjen e masave për përmirësimin e situatës.

2.2 Gjetje me efekte financiare negative në buxhetin e shtetit.

Gjatë periudhës Janar-Prill 2025, janë dhënë 14 rekomandime mbi gjetje me efekte negative në buxhetin e shtetit, për total vlerën 1,046,089 mijë lekë, nga të cilat:

- dëmi ekonomik vlerësuar 4,973 mijë lekë,
- menaxhimi jo efektiv i fondeve në vlerën 994,370 mijë lekë dhe;
- 46,746 mijë lekë në mangësi në aktivitetin kontrollues tatimor/doganor

2.3 Masa disiplinore dhe administrative.

Bazuar në Ligjin nr. 154, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, KLSH, për të metat dhe shkeljet e konstatuara, ka adresuar tek subjektet e audituara 5 rekomandime për masa administrative dhe disiplinore, nga të cilat 5 masa disiplinore.

Konkretisht, për shkeljet e konstatuara në bazë të ligjit të mësipërm, Ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, neni 58 dhe Kodit të Punës, KLSH u ka kërkuar organeve respektive shqyrtimin dhe marrjen e 4 masave disiplinore (pasi për 1 masë, punonjësit kanë rezultuar të larguar nga puna).

Nga rezultatet e auditimeve, gjatë kësaj periudhe, gjetjet e konstatuara i referohen:

- Shkelje të disiplinës financiare me ndikim negativ në performancën e administrimit të të ardhurave, shpenzimeve dhe në përdorimin e fondeve publike.
- Shkelje të konstatuara përgjatë zbatimit të punimeve - likuidime për punime të pakryera. Ndërsa në fushën e të ardhurave, peshën më të madhe e zënë të ardhurat e munguara nga administrimi i pasurisë shtetërore dhe marrëdhëniet kontraktuale me palët e treta
- Mangësi në aktivitetin kontrollues tatimor me ndikim negativ në performancën e administrimit të të ardhurave tatimore & doganore, si detyrime dhe penalitete të vlerësuara.

B- Mbi trajnimet e realizuara gjatë periudhës Janar-Prill 2025.

Gjatë periudhës janar - prill 2025, u realizuan 58 tema trajnimesh, nga të cilat 7 organizuar nga ASPA & 3 nga partnerë lokal; nga KLSH, 28 & 20 nga partnerë ndërkombëtarë si EUROSAT, SAI-e homologe si: SAI; Indisë; Izraelit; Norvegjisë; Suedisë, ZKA Kosovë. OECD etj. U trajnuan gjithsej 150 auditues, duke realizuar mesatarisht 14 ditë trajnimi/auditues për periudhën 4 mujore (nga 6 -8 ditë trajnimi që është objektivi 4 mujor). Ndërsa janë realizuar trajnime për 37 punonjës, staf jo-auditues, duke realizuar mesatarisht 8 ditë trajnimi/punonjës, në 4 muaj. Gjatë periudhës janar - prill 2025 rreth 22% e trajnimeve u realizuan në sallë, me prezencë fizike, ndërsa 78% e tyre on-line.

Ndër temat kryesore objekt trajnimi gjatë 4 mujorit të parë të vitit 2024, rendisim disa nga : temat si më poshtë:

E drejta e informimit dhe mbrojtja e të drejtave personale.

Integrimi Evropian.

Kodi i procedurave administrative.

Auditim i performancës.

Formulimi i gjetjeve, konkluzioneve dhe rekomandimeve në auditimet e performancës. Hartimi i procedurave të klasifikuara, legjislacioni i veçantë, si dhe çdo informacion tjetër, në lidhje me auditimin.

Identifikimi, regjistrimi si dhe auditimi i databazave shtetërore, Kodi Etik, LPP për zbatimin e kontratave, Manuali i Auditimit Financiar, Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë së Auditimit (SoAQM): Kalimi nga Kontrolli Cilësisë në, Menaxhim Cilësisë në KLSH, Standardet në auditim (INTOSAI), Auditimi cilësia e ujrave në plazhe, Auditimi i shërbimit psiko-social, Inteligjenca artificiale dhe ndikimi i saj në auditimin publik, Siguria e digave, Planet gjithëpërfshirëse të qeverisë dhe aspektet buxhetore për një popullsi në moshim, Keqpërdorimi i IT në krimet financiare, etj.

Një informacion më i detajuar në lidhje me veprimtarinë e kryer për periudhën Janar-Prill 2025, jepet në Buletinin Statistikor për këtë periudhë, të publikuar në faqen web të KLSH-së.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

Valbona Gaxha




ANEKSI nr.1 Raporti Përmbledhës i Shpenzimeve të Ministrisë/Institucionit Buxhetor

Periudha e Raportimit 4-2025

në/lekë

Kodi i grupit 24												
Shpenzimet e Ministrisë/Institucionit												
Emri i Programit	Viti paraardhës 2024		Periudha raportuese		Periudha raportuese		Periudha raportuese		Ndryshimi i planit		Ndryshimi Vjetor (Plan - Fakt)	% e realizimit
	Shpenzime Faktike	Struktura e shpenzimeve	Plani Vjetor Viti 2025	Struktura e shpenzimeve	Plani Vjetor i Rishtuar Viti 2025	Struktura e shpenzimeve	Ndryshimi i planit vjetor	Shpenzime Faktike të Periudhës/Progressive e	Struktura e shpenzimeve	7 (5-3)		
Shpenzimet sipas programeve buxhetore												
Emërtimi												
01120	613,038,159.50	100	694,000,000.00	100	695,500,000.00	100	1,500,000.00	194,526,228.00	100	500,973,772.00	28	
Vepimaria Audituese e KLSH												
Totali i Shpenzimeve buxhetore të Ministrisë (Kap 01.02.03.04.05.06.22)												
	613,038,159.50	100	694,000,000.00	100	695,500,000.00	100	1,500,000.00	194,526,228.00	100	500,973,772.00	28	
Shpenzime nga të Ardhurat Jashtë limitit (Kap 06)												
	2,908,165.00							0.00				
	615,946,324.50							194,526,228.00				
Shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik												
Emërtimi												
Artikulli												
600	456,120,688.00	74	531,300,000.00	77	531,300,000.00	76	0.00	153,520,482.00	79	377,779,548.00	29	
Paga												
601	69,813,026.00	11	66,800,000.00	10	66,800,000.00	10	0.00	23,683,275.00	12	43,116,725.00	36	
Sigurime Shoqërore												
602	71,082,161.50	12	80,900,000.00	12	80,700,000.00	12	-200,000.00	17,222,105.00	9	63,477,895.00	21	
Mallra dhe Shërbime të Tjera												
603	0.00	0	0.00	0	0.00	0	0.00	0.00	0	0.00	0	
Subvencione												
604	0.00	0	0.00	0	0.00	0	0.00	0.00	0	0.00	0	
Transferata Korrente të Brendshme												
605	292,166.00	0	0.00	0	0.00	0	0.00	100,396.00	0	99,604.00	50	
Transferata Korrente të Huaja												
606	1,150,880.00	0	0.00	0	200,000.00	0	200,000.00	0.00	0	1,500,000.00	0	
Trans per Buxh. Fam. & Individ												
	598,456,921.50	98	679,000,000.00	98	680,500,000.00	98	1,500,000.00	194,526,228.00	100	485,973,772.00	29	
Non-Totali Shpenzime Korrente												
230	4,007,113.00	1	0.00	0	0.00	0	0.00	0.00	0	0.00	0	
Kapitale të Patrupëzuara												
231	6,442,475.00	1	15,000,000.00	2	15,000,000.00	2	0.00	0.00	0	15,000,000.00	0	
Kapitale të Trupëzuara												
	10,449,588.00	2	15,000,000.00	2	15,000,000.00	2	0.00	0.00	0	15,000,000.00	0	
Non-Totali Shpenzime Kapitale me financim të brendshëm												
230	4,129,650.00	1	0.00	0	0.00	0	0.00	0.00	0	0.00	0	
Kapitale të Patrupëzuara												
231	4,129,650.00	0	0.00	0	0.00	0	0.00	0.00	0	0.00	0	
Kapitale të Trupëzuara												
	14,579,238.00	2	15,000,000.00	2	15,000,000.00	2	0.00	0.00	0	15,000,000.00	0	
Non-Totali Shpenzime Kapitale me financim të huaj												
	613,038,159.50	100	694,000,000.00	100	695,500,000.00	100	1,500,000.00	194,526,228.00	100	500,973,772.00	28	
Totali i Shpenz. Buxhetore të Ministrisë/Institucionit Buxhetor												
	2,908,165.00							0.00				
Shpenzime nga të Ardhurat Jashtë limitit (Kap 06)												
	615,946,324.50							194,526,228.00				
Totali (Korrente + Kapitale + Shpenz. nga të ardh. jashtë limitit												
Numri i punonjësve												
	0		0		0			0		0		



Handwritten signature: Jal Sona

Handwritten signature: Gaxho

Emri	
Firma	
Data	

Sekretari i Përgjithshëm

Nëntotali Shpenzime Kapitale me financim të huaj	4,129,650.00	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Total Shpenzime nga të ardhurat jashtë limitit (Kap 06)	2,908,165.00	100											
Kodi i produktit Emeritimi													
Shpenzime kapitale nga të ardhurat jashtë limitit (Kap 06)	2,908,165.00	100											
Kodi i produktit Emeritimi													
19AH803 Rikonstrukcione për ndërtesat	2,908,165.00	100											
Totali i Shpenzimeve të Programit	615,946,324.50		694,000,000		695,500,000		1,500,000		194,526,228.00			500,973,772	

Emri Firma Data	Emri		
	Firma		
	Data		
Emri Firma Data	Sekretari i Pergjithshëm		
	Emri		
	Firma		
			Data



LIMITE		Kodi i grupit										në/lekë		
Emri i		Kodi i programit										01120		
Emri i		Kodi i grupit										24		
Emri i		Kodi i programit										01120		
Kodi i Produktit	Emërtimi i Produktit	Njësia matëse	Viti paraardhës			Periudha Raportuese			Periudha Raportuese			Kosto për Njësi Faktike /në fund të vitit (në fund të vitit korent)		
			Sasia Faktike (Viti paraardhës)	Shpenzimet Faktike (sipas vitit paraardhës)	Kosto për Njësi (sipas vitit paraardhës)	Sasia (sipas planit Fillesar Vjetor)	Shpenzimet (sipas planit Fillesar Vjetor)	Kosto për Njësi (sipas planit Fillesar të vitit korent)	Sasia (sipas planit të rishikuar të vitit korent)	Shpenzimet (sipas /nplanit të rishikuar të vitit korent)	Kosto për Njësi/sipas /nplanit të rishikuar të vitit korent)			
			(1)	(2)	(3)	(4)	(5)	(6)	(7)	(8)	(9)	(10)	(11)	(12)
Produktet e realizuara me shpenzimet buxhetore të programit														
92401AA	Auditime të kryera	Nr audiimesh	155	598,458,922	3,861,025		679,000,000			680,500,000			194,526,228	
M240002	Blerje Autovetura	Nr automjete	1	4,920,000	4,920,000		3,000,000			3,000,000			0	
M240003	Rikonstrukcion Godine	cope		0	0		4,000,000			4,000,000			0	
M240009	Blerje pajisje kompjuterike	Nr pajisjesh		0	0		7,000,000			7,000,000			0	
M240010	Pajise të ndryshme zyre	Nr pajisjesh	22	1,522,475	69,203		1,000,000			1,000,000			0	
	Total			613,038,160			694,000,000			695,500,000			194,526,228	
Produktet e realizuara nga përdorimi i të ardhurave jashtë limitit (Nga kapitulli 06)														

Drejtuuesi i Ekipit Menaxhues të Programit	Emri		Emri	
	Firma		Firma	
	Data		Data	
		Sekretari i Përgjithshëm		
		Emri		
		Firma		
		Data		

Valbona Gashi



ANEKSI nr.4 Raporti i realizimit të treguesve të performancës së programit

Periudha e Raportimit 4-2025

Emri i Grupit	Kontrolli Lartë i Shtetit	Kodi i Grupit	24
Emri i Programit	Veprimtaria Audituese e KLSH	Kodi i Programit	01120

Qëllimi i politikës së programit
 Ushtrimi i veprimtarisë audituese në një linjë me standartet ndërkombetare të auditimit mbi përdorimin me efektivitet efience dhe ekonomicitet të fondëve publike në funksion të rritjes së përgjegjshmërisë së menaxhimit të financave e pasurisë publike duke sjelle vlerë të shtuar për shoqërinë dhe ndryshim në jetën e qytetareve

Treguesit e performancës/Produktet:									
Kodi i treguesit	Emërtimi i treguesit	Tregues me bazë gjinore (PO)	Njësia matëse	Fakti i Vitit Paraardhës	Buqsheti Vjetor Plan Fillëstar Vitit 2025	Fakti i Periudhës/progressive	Ndryshimi (Plan - Fakt)	% e realizimit	
Objektivat e politikës së programit									
Trendi në mijë e nivellit të pranueshmërisë së rekomandimeve									
Objektivi	Rritja e impaktit të punës audituese nëpërmjet përmirësimit të nivelit të zbatimit të rekomandimeve			75%	75%	75%		75%	0
Produktet									
Kodi i treguesit	Emërtimi i treguesit								
92401AA	Auditime të kryera	Nr auditimesh		155	680,500,000	194,526,228	485,973,772		0
M240009	Pajisje kompjuterike të blera	lehtë Nr pajisjesh		598,458,922	679,000,000				29
M240010	Pajisje zyre të blera	lehtë Nr pajisjesh		0	7,000,000	0	7,000,000		0
M240002	Automjete të blera	lehtë Nr automjete		22	1,000,000	0	1,000,000		0
M240003	Rikonstrukcion godine	lehtë Cope		1,522,475	3,000,000	0	3,000,000		0
		lehtë		1	4,000,000	0	4,000,000		0
				4,920,000	4,000,000	0	4,000,000		0
				0	4,000,000	0	4,000,000		0

Sekretari i Përgjithshëm

Emri: *Valbona Goxha*

Firma: *[Signature]*

Data:

